

Në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacione dhe për sponsorizime në veprimtari publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.47/06, 86/08, 51/11, 28/14 dhe 153/15), neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, me rastin e Kërkesës, lutjes nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë nr.04-25 datë 11.03.2025 (nr ynë.ark.03-988/1 datë 11.03.2025) dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr. 02-999/4 datë 19.03.2025, Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele miratoi si vijon:

VENDIM

për dhënien e ndihmës financiare – donacion Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë

1. I ndahet ndihma financiare – donacion Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, në shumë prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarë, për sanimin e pasojave nga zjarri që më datë 08.03.2025 ka përfshirë një pjesë nga ambientet e transmetuesit, me qëllim përkrahjen e aktiviteteve të transmetuesit për kryerjen pa pengesa të veprimtarisë së tij – transmetim të emisionit televiziv dhe përmbajtjeve me rëndësi për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçisht, Bogovinë, Bervenice, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), si dhe sigurimin dhe mbrojtjen e punonjësve.
2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, ndahen nga mjetet financiare të Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) për vitin 2025 dhe janë të parapara me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe pagohen në llogari të posaçme të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë numër: 290-4000001362-19, depozitues i TTK Bankë Tetovë, numri tatimor 4028995108379.
3. Për dhënien e ndihmës financiare – donacion nga pika 1 e këtij Vendimi, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, që hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Drejtuari Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, është dorëzuar Kërkesë, lutje nr.04-25 datë 11.03.2025 (nr ynë.ark.03-988/1 datë 11.03.2025), për dhënien e mjeteve financiare – donacion me rastin e zjarrit të shkaktuar më 08.03.2025 në ambientet e transmetuesit që ka shkaktuar ndërprerjen e programit, dhe si rezultat i zjarrit janë djegur të gjitha instalimet elektrike, një pjesë e pajisjeve, të gjithë kondicionerët, pajisjet e ventilimit, skenografia, një pjesë e Arkivit dhe një pjesë e mureve

të prekura nga zjarri. Si shtojcë të Kërkesës në fjalë janë dorëzuar dhe fotografi dhe video inçizim të ambienteve të televizionit pas rënies së zjarrit.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtari publike, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, ark.nr.02-999/4 datë 19.03.2025, Drejtori i Agjencisë miratoi vendim për dhënien e ndihmës financiare – donacion Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, në shumë prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarë. Në pajtim me këtë vendim, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, detyrohet që mjetet e dhëna t'i shfrytëzojë në veçanti për qëllimin e përcaktuar në pikën 1. Mjetet financiare të dhëna nga pika 1 e këtij Vendimi, ndahen nga mjetet financiare të Agjencisë për vitin 2025 dhe janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe shkarkohen në llogarinë e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë numër: 290-4000001362-19, depozitues i TTK Bankë Tetovë, numri tatimor 4028995108379.

Për lëndën, dhënie të ndihmës financiare, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Mevaip SHPKNJP Tetovë, që hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv me interes publik nga Ministria e Drejtësisë së RMV-së.

Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Bazuar nga sa më sipër u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Drejtori,
Dr. Zoran TRAJÇEVSKI**